



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 83/2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 93/2017
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2021.

KRYETARI

Miratuar në datën 23.12.2020



**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT**

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
		(2)
I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOMISIONERËT	G3*	(11)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(36)
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I-a		1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(16)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	6
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-a	2
Përkthyes	II-b	5
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-a	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(10)

Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	1
Specialist protokoll/arkivi ****	IV-a	2
Magazininier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	2
Shofer/ Korrier	VI	1
Total		76

Shënim:

**Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

***Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit, është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

****** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore*

Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

